



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë)*

*(Mbajtur, më 14.03.2024)*

*Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.*

*Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 11:11.*

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës online:

- 1. Ilir Rusi (zëvendëskryetar)*
- 2. Klodian Kurushi (anëtar)*
- 3. Fatmira Luli (anëtare)*
- 4. Emona Muçi (anëtare)*
- 5. Ridvan Hado (anëtar)*
- 6. Alban Toro (anëtar)*
- 7. Gentiana Muçaj (anëtare)*
- 8. Markelian Koça (anëtar)*
- 9. Yllka Rupa (anëtare)*

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Irena Plaku.*

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

*Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 14.03.2024*

**2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.**

**3. Etrita Petriti, Drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.**

**4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**

**5. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e ditës së premte, datë 15.03.2024, ditë pushimi”, i përgatitur nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative.

**Ilir Rusi:** Deklaroj të hapur mbledhjen e ditës së sotme datë 14.03.2024, ora 11:00, me rend dite shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin e ditës së premte, datë 15.03.2024, ditë pushimi”, për të cilën është përgatitur relacioni nga strukturat përkatëse. Për më tej fjalën për relatorin.

**Etrita Petriti:** Përshëndetje!

Kemi paraqitur përpara jush relacionin mbi projektvendimin “Për caktimin e ditës së premte, datë 15.03.2024, ditë pushimi”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, është organi kompetent i cili miraton akte nënligjore normative, në zbatim të ligjeve të tjera, me ndikim të përgjithshëm detyrues për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore.

Në referim të vendimit nr. 156, datë 13.03.2024 të Këshillit të Ministrave, në harmonizim të veprimtarisë së administratës shtetërore me atë të sistemit gjyqësor, si dhe ndodhur përpara faktit kur administrata shtetërore, për datën 15.03.2024, është në ditë pushimi, fakt i cili pengon veprimtarinë normale të sistemit gjyqësor, parashtrajmë përpara jush projektvendimin për caktimin e datës 15.03.2024 si ditë pushimi edhe për sistemin gjyqësor.

Në pikën 2 të projektvendimit, është përcaktuar përjashtimi nga zbatimi i pikës 1 të tij, gjyqtarët dhe administrata gjyqësore që kanë për shqyrtim gjykime me karakter të ngutshëm procedural të cilat shqyrtohen brenda 48 orëve.

Në pikën 3 të projektvendimit, janë përcaktuar strukturat funksionale të cilat ngarkohen me zbatimin e tij.

Në projektvendim përcaktohet hyrja në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

**Ilir Rusi:** Faleminderit zonja Etrita.

Ka diskutime për sa u parashtrua?

*(Nuk ka diskutime.)*

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit përkatës.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Alban Toro:** Dakord.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Markelian Koça:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Emona Muçi:** Dakord.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Gentiana Muçaj:** Dakord *(votë të cilën e ka shprehur me shkrim në dritaren e chat-it të platformës, dokument bashkëlidhur procesverbalit të sigluar).*

Vendim “Për caktimin e ditës së premtë, datë 15.03.2024, ditë pushimi”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përputhje me bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e ditës së premtë, datë 15.03.2024 ditë pushimi për gjyqtarët, administratën gjyqësore dhe administratën e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Përjashtohet nga zbatimi i pikës 1 të këtij vendimi, gjyqtarët dhe administrata gjyqësore që kanë për shqyrtim gjykime me karakter të ngutshëm procedural të cilat shqyrtohen brenda 48 orëve.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative, si dhe Shërbimet e Marrëdhënieve me Publikun të Gjykatave për zbatimin dhe njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Kalofshi mirë këto ditë pushimi.

Mirë u takofshim ditën e hënë.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Zëvendëskryetar**

**Illir Rusi**

**Specialiste**

**Rosalba Xhabrahimi**